



Tafane Kano  
d.f.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Alberte Busliari  
Gentle Dashi  
Arllenda Suci  
Ysida Monopoli  
Ishyq V

Nr. 1034 / Prot.

Vlorë më, 10.10.2023

VENDIM  
Nr. 52, datë 06.10.2023

**PËR  
NUMRIN MINIMAL TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË TË  
STUDIMIT QË DO TË AKTIVIZOHEN PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË  
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", Urdhërit të përbashkët nr.10, datë 10.07.2023 të RASH dhe QSHA "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024", shtojca 1, pika j, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 06.10.2022,

**VENDOSI:**

1. Numri minimal i studentëve të regjistruar që mundësojnë aktivizimin e një programi studimi për ciklin e parë të studimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, të cilët nuk janë prioritet kombëtar dhe nuk janë pjesë e fushave dhe programeve të Vendimit nr. 386, datë 01.06.2022 do të jetë 5 (pesë).
  2. Numri minimal i studentëve të regjistruar që mundësojnë aktivizimin e një programi studimi të ciklit të parë të studimit në UV, të cilët janë prioritet kombëtar dhe janë pjesë e fushave dhe programeve të Vendimit nr. 386, datë 01.06.2022 do të jetë 3 (tre).
  3. Ky vendim ka fuqi vepruese vetëm për vitin akademik 2023-2024. Për vitin akademik 2024-2025 SA do të marrë një tjetër vendim para fillimit të vitit akademik 2024-2025.
  4. Për vitin akademik 2023-2024 nuk do të aktivizohen programet e studimit të ciklit të parë të studimit si më poshtë:
    - a) Gjuhë Italiane (FSHH)
    - b) Kimi (FSHTN)
    - c) Matematikë (FSHTN)
  5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat akademike, ndihmësakademike e administrative si dhe Autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

Adresa / Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288

Web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)

Faqe 1 nga 1

